

| 1. Kontakti | |
|--|---|
| 1.1. Organizata kontaktuese: | Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK |
| 1.2. Njësia kontaktuese në organizatë: | Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit - Sektori i Statistikave të Bujqësisë |
| 1.3. Emri i kontaktit: | Hasime Bytyqi, Arlinda Berisha Emini |
| 1.4. Funksioni i personit kontaktues: | Zyrtare e Lartë në Sektorin e Bujqësisë |
| 1.5. Adresa e postës kontaktuese: | Rruga "Zenel Salihu" no 4. 10000 Pristina, Kosovo |
| 1.6. Adresa e emailit kontaktues: | hasime.bytyqi@rks-gov.net, arlinda.berisha@rks-gov.net |
| 1.7. Numri kontaktues: | + 381 38 200 31 156, + 381 38 200 31 155 |
| 1.8. Numri kontaktes i faksit: | Nuk ka numër të faksit në dispozicion. Numri i faksit është i përgjithshëm: +381 38 235 033 |

| 2. Prezantimi i statistikave | |
|---|--|
| 2.1. Përshkrimi i të dhënave: | Objektivë e Anketës së Ekonomive Bujqësore 2015 është që të ofroj të dhëna mbi gjendjen e bujqësisë në Kosovë, shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore, blegtorinë, inputet bujqësore (plehrat minerale, organike, pesticidet) dhe shpenzimet e fermës. Anketa synon që të ndihmoj në llogaritjen e nivelit të zhvillimit të sektorit të bujqësisë në Kosovë dhe të ofroj bazat për monitorimin e ardhshëm të trendëve në këtë sektor. |
| 2.2. Sistemi i klasifikimit: | Nuk aplikohet ndonjë klasifikim. |
| 2.3. Mbulimi nga sektori: | Në anketën e ekonomive bujqësore janë përfshirë vetëm ekonomitë bujqësore, të cilat e kanë plotësuar të paktën një nga kriteret e mëposhtme: Ekonomia punon 10 ari (1000 m ²) ose më shumë tokë bujqësore të shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore; Ekonomia prodhon perime, lule ose produkte të tjera bujqësore në serra për shitje; Ekonomia mban një ose më shumë gjedhe ose kuaj; Ekonomia mban të paktën 3 derra të rritur; Ekonomia mban të paktën 4 krerë të rritur të deleve ose dhive dhe derrave së bashku; Ekonomia mban të paktën 50 shpezë të rritura dhe lepuj femra së bashku; Ekonomia mban të paktën 20 koshere bletësh; Ekonomia prodhon kërpudha për shitje. |
| 2.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet: | Anketa është kryer duke përdorur këto definicione : Ekonomia Bujqësore është një njësi e pavarur teknike dhe ekonomike e prodhimit, ku (1) ekonomia familjare ose (2) subjekti juridik kryen (3) veprimtarinë bujqësore si aktivitet kryesor ose dytësor, nën një menaxhim të vetëm dhe ku i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit (tokën, blegtorinë, pajisjet, ndërtesat, etj.). Disa nga konceptet dhe definicionet e përdorura janë: ekonomia familjare, ekonomia familjare bujqësore, subjektet juridike, prodhimtaria bujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, toka e punueshme- ara, kopsht, mbajtja e kafshëve, sipërfaqja e korrur, gjithsej prodhimi, plantacionet e pemëve, pemishtet ekstenzive, plantacionet e vreshtave, vreshtat, fidanishtet, livadhet, kullotat etj. |

| | |
|------------------------------|---|
| 2.5. Njësia statistikore: | Njësitet e anketës janë ekonomitë bujqësore (Ekonomitë familjare bujqësore si dhe subjektet juridike që merren me aktivitet bujqësor). |
| 2.6. Popullsia statistikore: | <p>Ekonomi Familjare Bujqësore - është një familje ose komunitet i njerëzve, ku anëtarët e saj janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor ose dytësor, kanë një menaxhim të vetëm dhe i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit, të tilla si: tokën, makinat, ndërtesat, etj. Ekonomia Familjare Bujqësore mund të prodhojë produkte bujqësore për shitje, për konsum vetanak ose për të dyja.</p> <p>Subjektet Juridike - janë kooperativat bujqësore, bizneset individuale dhe format e tjera organizative me statusin e subjektit juridik, që janë regjistruar se kanë prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor; si dhe ndërmarrjet, institucionet dhe subjektet e tjera juridike, që janë regjistruar në një aktivitet tjetër, e të cilat kanë degë organizative ose pjesë të tjera organizative, ku kryhet prodhimi bujqësor.</p> <p>Prodhimtaria bujqësore nënkupton: Kultivimin e kulturave bujqësore (drithëra, patate, bishtajore të thara me kokërr, kultura industriale, bimë foragjere, perime, lule, bimë dekorative, farëra, fidane, pemë, rrush, kërpudha, etj.); Rritjen e bagëtisë, shpezëve dhe kafshëve të tjera (gjedhe, dele, dhi, derra, kuaj, gomarë, mushka, pula, bletë, lepuj, etj.); dhe Prodhimin e verës nga rrushi i prodhuar në Ekonominë Bujqësore.</p> |
| 2.7. Zona referuese: | Kosova (niveli kombëtar). |
| 2.8. Mbulimi kohor: | Seritë kohore janë në dispozicion nga viti 2004 deri te 2015. |
| 2.9. Periudha bazë | Nuk ka indeks të përdorur. |

| 3. Përpunimi statistikor | |
|--|--|
| 3.1. Burimi të dhënave: | Anketa e ekonomive bujqësore është e bazuar në mostër. Si burim për dizajnimin e mostrës së Anketës së Ekonomive Bujqësore 2015 është shfrytëzuar Regjistrimi i Bujqësisë (RB) 2014 që është kryer në nëntor 2014. Për ta bërë dizajnin e mostrës, e cila do të çonte në saktësi të pranueshme për të gjitha ose të paktën për shumicën e variablave kryesore janë analizuar një numër i konsiderueshëm i variablave. Për dizajnin përfundimtar të mostrës janë marrë në konsiderim këta parametra: Madhësia e mostrës 6999, Stratifikimi (Shtrësëzimi), Alokimi (Shpërndarja). Stratifikimi është bërë sipas rajoneve, madhësisë së klasës dhe tipit të fermave. Përzgjedhja e Ekonomive Bujqësore për intervistë është bërë me metodën e rastit. |
| 3.2. Shpeshësia e mbledhjes së të dhënave: | Të dhënat grumbullohen në baza vjetore. |
| 3.3. Mbledhja e të dhënave: | Për të mbledhur të dhëna për AEB është përdorur Intervista personale e asistuar në letër (PAPI). Metoda e grumbullimit të të dhënave ishte intervista ballë-për-ballë me pyetësor. Anketa është kryer nga Operatori Ekonomik, ku ka angazhuar anketuesit në terren për kryerjen e anketës. Anketuesit paraprakisht janë trajnuar për plotësimin e pyetësorit dhe për realizimin e anketës. |
| 3.4. Vlefshmëria e të dhënave: | Kontrolluar nga ri-kontaktimi në teren i ekonomive bujqësore pas përfundimit nga intervistuesit, vazhdohet me kontrollin logjik në zyrë para se të bëhet futja e të dhënave. Kontrollimi i të dhënave pas futjes së të dhënave, krahasimi i të dhënave me të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë 2014 dhe të dhënat administrative, kalkulimi i shkallës së përgjigjes. |

| | |
|-----------------------------|--|
| 3.5. Hartimi i të dhënave: | Në mënyrë që vlerësimet në mostrën e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) 2015 në Kosovë të jenë përfaqësuese të popullsisë, të dhënat duhet të shumëzohen me peshën e mostrës. Pësha bazë për çdo ekonomi familjare në mostër është e barabartë me inversin e probabilitetit të përzgjedhjes (llogaritet duke shumëzuar probabilitetet në secilën fazë të mostrimit). Pësha për një ekonomi familjare i bashkangjitet të dhënave për ekonomitë familjare në bazën e të dhënave. Probabiliteti i përzgjedhjes bazohet në një dizajn mostre një fazë. Në këtë fazë janë përzgjedhur ekonomitë familjare me alokim optimal në secilën shtresë (rajoneve, tipit të fermës, madhësisë së klasave) duke marrë për bazë variablën shfrytëzimin e tokës bujqësore si variabël ndihmëse. |
| 3.6. Përshtatja/rregullimi: | Peshat janë rregulluar bazuar në rregullimit të njësisë që nuk janë përgjigjur. |

| 4. Menaxhimi i cilësisë | |
|----------------------------|--|
| 4.1. Sigurimi i cilësisë: | ASK është e angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në "LIGJIN Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS", ASK përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të saj, ASK ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). ASK ka zhvilluar një Deklaratë të Cilësisë e cila gjendet në faqen e internetit të ASK-së: http://ask.rks-gov.net/media/1889/deklarata-e-cilesise.pdf . Dokumenti përmban njëmbëdhjetë parime, në përputhje me parimet e CoP, si pavarësia profesionale dhe konfidencialiteti statistikor, në të cilat bazohet puna e ASK-së. |
| 4.2. Vlerësimi i cilësisë: | Gjatë vitit 2017 Në Agjencinë e Statistikave të Kosovës është kryer procesi i vlerësimit të Sistemit Statistikor të Kosovës përmes qasjes "Peer Review". |

| 5. Relevanca | |
|----------------------------------|--|
| 5.1. Nevojat e përdoruesit: | Anketa e ekonomive bujqësore publikon të dhëna themelore të nevojshme për hartimin dhe vlerësimin e politikave bujqësore në nivel kombëtar. Rezultatet e anketës përdoren nga: Qeveria, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Institucionet kërkimore dhe universitetet, shoqatat e fermerëve, hulumtuesit, gazetarët, studentët, etj. |
| 5.2. Kënaqshmëria e përdoruesit: | Njëra ndër elementet kyçe për të siguruar cilësinë e të dhënave statistikore është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve. Anketa ka për qëllim që të grumbulloj informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve dhe shfrytëzuesve të të dhënave zyrtare statistikore. Me anë të kësaj ankete shfrytëzuesit e të dhënave statistikore kanë shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me pikëpamjet statistikore, kanë dhënë këshilla dhe sugjerime lidhur me nevojat e tyre për statistika si dhe për përmirësimin e këtyre të dhënave statistikore në të ardhmen. Këtë vit u zhvillua për herë të dytë Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve. Qëllimi i këtij ankete është të matë nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të të dhënave dhe të kemi informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve. Pyetësi u plotësua nga 34 përdorues, të përbërë nga 14 pyetje. Rezultatet e këtij studimi do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së. |

| | |
|---------------------------------|-------------------------|
| 5.3. Plotësia: | Nuk është e zbatueshme. |
| 5.3.1. Data completeness - rate | Nuk është e zbatueshme. |

6. Saktësia dhe besueshmëria

| 6.1. Saktësia e përgjithshme: | Anketa e Ekonomive Bujësore mbulon ekonomitë familjare bujqësore si dhe subjektet juridike që merren me aktivitet bujqësor. Ndërsa rezultatet bazohen në një mostër të ekonomive bujqësore, ato i nënshtrohen llojeve të zakonshme të gabimeve që lidhen me teknikat e nxjerrjes së mostrave dhe intervistave, siç janë gabimet e njerrjes së mostrave, gabimet gjatë fazës së intervistimit, gabimet e matjes, gabimet e përpunimit dhe mosgjigjet. Gabimet e mostrimit shoqërohen nga devijime statistikore. Për këtë arsye, janë llogaritur devijimet standarde të zgjedhjes së përdorur për interpretimin e rezultateve të anketës. | | | | | | | | | | |
|--|---|----------|---------------------------|------------------------------|-------|------------------------|-------|--------------------------------|--------|----------------------|-------|
| 6.2. Gabimi në mostra: | Efekti i rastësishëm për shkak të mostrimit do të thotë se rezultatet e llogaritura nga mostra të ndryshme devijojnë disi nga njëri-tjetri. Pasaktësia për shkak të dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës vlerësohet me gabimin standard të vlerësimit. Madhësia e gabimit standard ndikohet nga madhësia e mostrës dhe varianca e variablave që janë objekt studimi. | | | | | | | | | | |
| 6.2.1. Gabimi në mostra-treguesit | Bazuar në dizajnin e mostrës të startifikuar me një fazë nga rezultatet e anketës është llogaritur koeficienti variacionit për variablat kyçe: <table border="1" data-bbox="441 886 1053 1161"> <thead> <tr> <th>Variabla</th> <th>Koeficienti i Variacionit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Toka e shfrytëzuar bujqësore</td> <td>1,65%</td> </tr> <tr> <td>Toka e punueshme - ara</td> <td>1,59%</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej kulturat e përhershme</td> <td>12,51%</td> </tr> <tr> <td>Livadhe dhe kullosat</td> <td>1,70%</td> </tr> </tbody> </table> | Variabla | Koeficienti i Variacionit | Toka e shfrytëzuar bujqësore | 1,65% | Toka e punueshme - ara | 1,59% | Gjithsej kulturat e përhershme | 12,51% | Livadhe dhe kullosat | 1,70% |
| Variabla | Koeficienti i Variacionit | | | | | | | | | | |
| Toka e shfrytëzuar bujqësore | 1,65% | | | | | | | | | | |
| Toka e punueshme - ara | 1,59% | | | | | | | | | | |
| Gjithsej kulturat e përhershme | 12,51% | | | | | | | | | | |
| Livadhe dhe kullosat | 1,70% | | | | | | | | | | |
| 6.3. Gabim jo-i mostrave: | Gabimet e mos marrjes së mostrave janë gabimi që ka ndodhur gjatë fazave të tjera të anketës: Gabimi i mbulimit janë gabimet që lidhen me kornizën; divergjencat midis kornizës dhe popullatës së synuar. Gabimet që ndodhin gjatë grumbullimit të të dhënave, gabimet e përpunimit dhe gabimi i mos përgjigjes kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve. | | | | | | | | | | |
| 6.3.1. Mbulimi i gabimit | Korniza e përdorur është nga Regjistrimi i Bujqësisë 2014. Gabimi i nën mbulimit është se njësitë e popullatës së synuar nuk janë të qasshme nëpërmjet kornizës dhe ato gabime janë të vështira për t'u matur. Gabimi mbi mbulimin janë njësitë e gabimit të arritshme nëpërmjet kornizës që nuk i përkasin popullatës së synuar. Fokusi kryesor ishte mbi gabimin e mbi mbulimit. | | | | | | | | | | |
| 6.3.1.1. Mbi-mbulimi – norma, shkalla | Mbulimi mbulon ekonomitë që nuk merren më me bujqësi, shtëpi bosh, shtëpi të shkatërruara etj. Shkalla e mbi mbulimit është 6,18%. | | | | | | | | | | |
| 6.3.1.2. Njësitë e përbashkëta - proporcioni | Nuk është në dispozicion. | | | | | | | | | | |
| 6.3.2. Gabimi në matje | Trajnimi i anketuesve, monitorimi i punës në terren etj. | | | | | | | | | | |

| | |
|---|--|
| 6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje | Gabimet e mos përgjigjes janë gabimet kur anketuesi nuk arrin të marrë një përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve. |
| 6.3.3.1. Njësia jo-përgjigje - norma për P | Shkalla e mos përgjigjes është 22,34%. |
| 6.3.3.2. Artikulli jo-përgjigje - norma për P | Nuk është në dispozicion. |
| 6.3.4. Gabimi në përpunim | Gabimet e përpunimit të të dhënave janë për shkak të futjes së të dhënave, gabimet e anketuesve, etj. |
| 6.3.4.1. Norma e Imputimit | Imputimi është bërë në nivelin e njësive të ekonomive bujqësore të cilat nuk janë intervistuar. Nga burimet administrative kemi përdorur të dhëna nga regjistri i vreshtarisë (MBPZHR) për zonën e vreshtave dhe prodhimin, numri i hardhive, dhe këto të dhëna janë ndarë sipas llojit të rrushit (rrushi i tryezës dhe rrushi i verës). Kjo zonë ishte përfshirë në shfrytëzimin e tokës. Shkalla e imputimit është 6,62%. |
| 6.3.5. Gabimi në supozim të modelit | Nuk është në dispozicion. |
| 6.4. Rishikimi i të dhënave | Nuk është në dispozicion. |
| 6.5. Rishikimi i të dhënave - politika: | Në ASK nuk ka politika të rishikimit. |
| 6.6. Rishikimi i të dhënave - praktika: | Është kryer rishikim për kulturat bimore bujqësore 2007-2014. |
| 6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare | Nuk është në dispozicion. |

| 7. Afati kohor dhe përpikëria | |
|---|--|
| 7.1. Afati kohor: | Periudha e referuese për shfrytëzimin e tokës është viti i bujqësorë (31 tetor 2014 - 1 nëntor 2015). Në blegtori është 1 nëntori 2015 për numrin e kafshëve. |
| 7.1.1. Vonesat në kohë – rezultatet e para | Nuk është në dispozicion. |
| 7.1.2. Vonesat në kohë – rezultatet përfundimtare për P | Publikimi i rezultateve përfundimtare është 30 shtator 2016. |
| 7.2. Përpikëria: | Të dhënat e AEB 2015 nuk janë publikuar në kohë. |
| 7.2.1. Përpikëria - ofrimi dhe publikimi për P | Vonesa në kohë është 12 ditë. |

| 8. Koherenca dhe krahasueshmëria | |
|--|--|
| 8.1. Krahasueshmëria - gjeografike: | Statistikat i referohen vetëm nivelit kombëtar. Metodologjia e AEB është bazuar në standardet ndërkombëtare kështuqë të dhënat janë të krahasueshme në nivel kombëtar. |
| 8.1.1. Asimetria për pasqyrën e rrjedhës së statistikave - koeficienti | Nuk është në dispozicion. |
| 8.2. Krahasueshmëria nëpër kohë: | Nga viti 2004 deri në vitin 2013 është mbajtur anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore. Në nëntor 2014 është kryer Regjistrimi i Bujqësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare, i cili siguron kornizë të re të mostrave për AHS 2015 dhe rishikimin e serive kohore të kulturave bimore bujqësore 2007-2014. Në vitin 2015 anketa e ekonomive bujqësore është realizuar sipas metodologjisë së harmonizuar me metodologjinë e Eurostat (pyetësi, udhëzuesi, definicionet) që mundëson krahasueshmërinë ndërkombëtare të të dhënave. |
| 8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme për P | Krahasueshmëria është nga 2004 - 2006. CC2 = 3. Krahasueshmëria është nga 2007 - 2015. CC2 = 9. |
| 8.3. Koherenca – fushat e ndërlidhura: | Të dhënat vjetore të AEB janë përdorur për: Llogaritjet ekonomike për bujqësi, Indeksi i Çmimeve dhe Çmimet në Bujqësi, Llogaritë kombëtare. |
| 8.4. Koherenca – statistikat gjysmë-vjetore dhe vjetore | Nuk është në dispozicion. |
| 8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare | Të dhënat nga AEB përdoren nga Llogaritë Kombëtare. |
| 8.6. Koherenca - e brendshme: | Të dhënat kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të tyre. Të dhënat janë koherente në aspektin e brendshëm. |

| 9. Qasja dhe qartësia | |
|---|--|
| 9.1. Njoftimet për shtyp: | Njoftimet për shtyp janë on-line në kohën e shpërndarjes së të dhënave. Përshkrimi i shkurtër është në dokumentacionin e metodologjisë që përfshin: të dhënat për shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës bujqësore, kulturat bujqësore dhe blegtorinë, inputet bujqësore (plehrat minerale, organike, pesticidet) dhe shpenzimet në ekonomitë bujqësore. |
| 9.2. Publikimet: | Publikimet e ASK-së, tabelat dhe materialet për njoftim për shtyp, janë gjithmonë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht. |
| 9.3. Baza e të dhënave online: | ASK ka bazën e të dhënave online: http://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pXweb/sq/askdata/?rxid=48d7fed2-90d9-4873-8854-c1e793ecafad . |
| 9.3.1. Tabelat e të dhënave - konsultimet | Nuk është në dispozicion. |
| 9.4. Qasja në mikro-të dhënat: | Përdoruesit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në mikro-të dhënat, por me ligj studiuesit/hulumtuesit dhe institucionet mund të kërkojnë qasje përmes ASK-së. |

| | |
|---|---|
| 9.5. Tjetër: | Të dhënat e AEB publikohen edhe në Vjetarin Statistikor të ASK. http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/te-pergijthshme/vjetaret-statistikor . |
| 9.6. Dokumentacioni mbi metodologjinë: | Metodologjia për AEB është përshkruar në publikim në pjesën e metodologjisë së anketimit: http://ask.rks-gov.net/media/3543/anketa-e-ekonomive-bujqesore-2015.pdf . |
| 9.7. Dokumentacioni për cilësi: | Metadeta nga statistikat e kulturave bujqësore janë dërguar në Eurostat. |
| 9.7.1. Shkalla e plotësisë për metadeta | Nuk është në dispozicion. |
| 9.7.2. Metadeta - konsultime | Nuk është në dispozicion. |

10. Kostoja dhe barra

Te dhënat grumbullohen nga operatori ekonomik. 5 anëtarë punonjës në zyrën kryesore (1 udhëheqës i njësisë si dhe 4 zyrtarë).

11. Konfidencialiteti

| | |
|--|--|
| 11.1. Konfidencialiteti - politika: | "Agjencia do të sigurojë që të dhënat individuale të mbledhura për qëllime statistikore, të mbledhura nga persona fizikë ose juridikë, apo organet dhe organizatat e administratës publike (më tej "Respodentët"), të trajtohen në mënyrë rreptësishtë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Ligji 04/L-036, Neni 34. "Të gjithë të anketuarit (respodentët) janë të detyruar, në pajtim me ligjin në fuqi, të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë të dhëna në kohë dhe me saktësi statistikore në Agjenci, dhe të bashkëpunojnë me Agjencinë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. LIGJI Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 21: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf . |
| 11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave: | Qasja në të dhënat konfidenciale do t'u lejohet vetëm personave të cilët janë përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare deri në atë nivel që këto të dhëna janë të nevojshme për prodhimin e statistikave. Neni 37, Ligji Nr 04/L-036: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf . |

12. Komentimi Fillimi

